

RAPORT VJETOR 2016



MAKE YOURSELF GREAT

PËRMBAJTJE

Parathënie	7
Vizioni - Objektivat - Strategjia	8
Përgjegjësi Shoqërore	11
Projekte	12
Burime Njerëzore	20
Marketing - Dizajn	23
Pasqyra Financiare	24



PARATHËNIE

Të nderuar klientë dhe partnerë, 2016 realizoi objektivin e kompanisë për një zhvillim të qëndrueshëm. Pas suksesit në Projektin Magnet, Kontakt identifikohet si një kompani me cilësi të lartë ndërtimi, shumë të kujdesshme ndaj shërbimit të klientit dhe korrektë në respektimin e afateve.

Në vitin 2017 Kontakt vazhdon të zhvillohet. Përfundon 150.000 m² në Magnet duke ndërtuar objektin Ara projektuar nga Daniel Libeskind. Fillon SiRI, 12.000 m² projektuar nga FORM, arkitektë të talentuar shqiptarë. Nis projekti Port 132.000 m² projektuar nga një ndër studiot më të mira të arkitekturës në botë, Office of Metropolitan Architecture, OMA.

Rritja e cilësisë në projektim dhe ndërtim, mbajtja nën kontroll e kostove të ndërtimit dhe investimit, ruajtja e ritmit të shitjes me 1 njësi/ditë, janë objektiva për t'u arritur në vitin 2017.

Rritja e punonjësve në përgjegjësi dhe pagë, shtimi i stafit me punonjës të rinj duke u dhënë atyre mundësinë të futen në tregun e punës dhe së bashku me punonjësit me eksperiencë të kualifikohen më tej, është objektivi i burimeve njëzore 2017.

Përgjegjësia shoqërore në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë pas eksperiencës së vitit 2016 në rikonstruksionin e 26 kopshteve, mbetet aktivitet kryesor për zhvillimin e Kontakt si një kompani që përmirëson jetën në komunitet.

Ambicja është që në vitin 2018, kushdo që flet për Kontakt, ta identifikojë atë si markë që ndërton objektë banimi cilësorë, me punonjës të rinj, të motivuar e të kualifikuar dhe e pranishme në komunitet me përgjegjësitë shoqërore.

VIZIONI:

Kontakt synon të jetë një kompani udhëheqëse në tregun e ndërtimit të objekteve të banimit në komplekse të mirëstudjuara e të mirëmbajtura, për të qënë zgjedhja e parë e klientit, për një shtëpi komode e bashkëkohore.

OBJEKTIVA:

Fleksibël për t'i shërbyer nevojave të klientëve, të kuptojmë klientin dhe të realizojmë produkte në përputhje me kërkesat duke ruajtur balancën Çmim – Cilësi.

Përgjegjësia mjedisore na ndërgjegjëson të ndërtojmë komplekse me hapsira të gjelbëra, kënde sportive, kënde pushimi dhe tarraca të gjelbëruara.

Krijojmë standarde në ndërtim dhe zhvillim projektesh duke pozitivisht në menyrën e të punuarit në sektorin e ndërtimit. Punonjësit ndjekin praktikat më të mira, duke siguruar cilësi dhe eficensë por mbi të gjitha fokusohemi së tepërmi në sigurinë dhe shëndetin në punë.

STRATEGJIA:

Përzgjedh projekte, ndërton rezidenca banimi. Rekruton, motivon dhe trajnon punonjës të talentuar, lë hapësira për konkurrencë dhe diversitet, duke synuar më të mirën për punonjësit dhe kompaninë.





PËRGJEGJËSI SHOQËRORE

Punimet kryesore e rikonstruktimit në 24 kopshtet dhe 2 çerdhe:


1. Drenazhime
2. Hidroizolime
3. Suvatime
4. Shtrim Pllaka dhe Laminat
5. Hidrosanitare
6. Mobilim dhe pajisje kuzhine
7. Sistemime të jashtme, ambjente të gjelbëruara dhe kënde lojrash.



MAGNET

Magnet është në përfundim të punimeve. Ai është projektuar për t'i ofruar të gjithë brezave një ambient sa më funksional dhe shlodhës.

Gjelbërimi dhe ambientet sportive ofrojnë zgjidhje shumë të vlefshme për banorët. Apartamentet janë modeluar me hapësira të bollshme dhe të përshtatshme, duke i bërë ato të përdorshme për një periudhë afatgjatë.





ARA

Objekti më i fundit në Magnet, i cili do të kurorëzojë përfundimin e punimeve në gjithë kompleksin.


Projektuar nga Daniel Libeskind, ai do të jetë një gur i çmuar, në qendër të kompleksit.



SIRI

Projekt i ri, me vendndodhje shumë pranë Bulevardit të Ri, fillon punimet në muajin Prill të 2017 dhe do të jetë një alternativë për të gjithë që dëshirojnë një apartament komod apo njësi shërbimi funksionale.

Objekti do të jetë 9 kate mbi tokë, me cilësi të lartë ndërtimi, me tarraca të gjelbëruara, të cilat do të jenë një avantazh i shtuar kundrejt konkurrentëve tanë.





PORT

Me një koncept arkitekture ekstravagant, projektuar nga studio Hollandeze OMA, me arkitekt drejtues Rem Koolhaas dhe Reinier De Graaf, ky kompleks i ri do të jetë sa bashkëkohor aq edhe tradicional, në risinë dhe vlerën që do ti sjellë zonës Jug-Lindore të Tiranës dhe qytetit në tërësi.

Me një morfologji urbane shumë të strukturuar në formën e kutive të shahut dhe objekte jo shumë të larta të cilat të lejon të shohësh qartë pamjen e Malit të Dajtit. Ngjyrat e ndryshme që do të përdoren në fasada do të jenë një aset tjetër shumë i veçantë, një praktikë shumë e njohur në qytetin e Tiranës në fasadat ekzistuese të ndërtesave rezidenciale të komunizmit që u pikturuan me motive me ngjyra në vitet 2000.

Plot me hapësira të lira që zenë rreth 70% të sheshit, ku do të organizohen rrugë për këmbësorë, hapësira të gjelbra e rekreative, sheshe lojrash dhe argëtimi, ndërkohë që gjithë parkimi i makinave do të jetë nëntokë, ky kompleks do të jetë plot ajër, dritë, gjelbërim, pamje të mrekullueshme, cilësi jetese.




BURIME NJERËZORE

Burimet njerëzore janë kapitali më i madh që Kontakt ka krijuar. Marrëdhënia nga të dy palët, shihet si një bashkëpunim afatgjatë dhe ky është një indikator shumë i mirë.

Punonjësit janë gjithnjë e më të kënaqur me kushtet aktuale të punës dhe përpjekjet e Kompanisë për të ruajtur dhe rritur standardet. Investojmë në trajnimin e kualifikimin e stafit, brenda dhe jashtë.

Për vitin 2016, kemi dyfishuar numrin e punonjësve, me objektivin të përzgjedhim dhe punësojmë punonjës të rinj të talentuar.



Grupmoshat e punonjësve





SHITJE & MARKETING

Për Vitin 2016 u realizua synimi për ngritjen, plotësimin dhe konsolidimin e departamenteve Shitje dhe Marketing, me synime dhe objektiva të qarta.

Për vitin e porsa mbyllur ne kemi realizuar 371 kontrata shitje, pra kemi finalizuar 371 klientë, të cilët kanë zgjedhur produktin tonë; apartamente, vend parkime apo njësi shërbimi.

Ne punojmë me moton “Askush më mirë se ne nuk mund të prezantojë, marketojë dhe shesë produktin tonë”.

DIZAJN

Si një Kompani e së ardhmes, Kontakt adopton mënyra bashkëkohore për të rritur interesin e blerësve për produktet e veta. Një vlerë e shtuar e punës tonë është edhe dizajn për cdo material marketing.


Dizajni tek ne aplikohet në raport të drejtë me progresin dhe konceptohet bazuar në ide, ndërveprime, informacione, postera, produkte, vende, shenja, sisteme, shërbime, mobilje urbane, faqet e internetit.



POZICIONI FINANCIAR - AKTIVET


Bilanci Kontabel me 31 Dhjetor 2016
(shumat në Lekë)

	1000		/000 €
	135.23	137.28	
AKTIVET	2016	2015	Δ %
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	1,490	1,127	32
Aktivet afatgjata jomateriale	1	1	(14)
Totali i aktiveve afatgjata	1,491	1,129	32
Aktivet afatshkurtra			
Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
Llogari / Kërkesa te arketueshme	6,187	5,895	5
Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme	349	380	(8)
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	1,737	-	
Investime të tjera financiare	1,412	1,000	41
	9,684	7,275	33
Inventari			
Lëndët e para	233	281	(17)
Parapagesat për furnizime	181	45	306
	414	325	27
Mjete Monetare			
Mjete monetare	918	1,916	(52)
	918	1,916	(52)
Aktivet totale afatshkurtra	11,016	9,517	16
TOTALI I AKTIVEVE	12,507	10,645	17



POZICIONI FINANCIAR - DETYRIMET DHE KAPITALI

PASIVET DHE KAPITALI	2016	2015	Δ %
KAPITALI			
Kapitali	2,919	2,175	34
Rezerva Ligjore	9	9	2
Fitim (Humbje) e vitit financiar	1,009	729	38
	3,937	2,914	35
Pasivet Afatgjata			
Grande dhe të ardhura të shtyra	152	150	
Totali i pasiveve Afatgjata	152	150	2
Pasivet Afatshkurtra			
Huamarjet			
Huatë dhe parapagimet			
Të pagueshme ndaj furnitorëve	935	628	49
Të pagueshme ndaj punonjësve	32	15	111
Detyrime tatimore	145	55	163
Të tjera detyrime	84	85	(0)
Parapagime të arkëtuara	7,222	6,799	6
Totali i pasiveve Afatshkurtra	8,418	7,582	11
TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT	12,507	10,645	17
	(0.00)	0.00	



PASQYRA E PERFORMANCËS

Llogaria të Ardhura & Shpenzime për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
(shumat në Lekë)

Emërtimi	2016	2015	Δ %
Shitjet neto	14,516	10,054	44
Mallrat, lëndët e para dhe shërbimet	(3,931)	(3,048)	29
Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	(8,664)	(5,396)	61
Shpenzime të personelit	(656)	(390)	68
Rënia në vlerë (zhvlerësimi) dhe amortizimi	(161)	(98)	65
Fitimi (humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit	1,104	1,122	(2)
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	83	(240)	134.57
Fitimi (humbja) para tatimit	1,187	882	35
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	(178)	(153)	17
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar	1,009	729	38

FLUKSI I MJETEVE MONETARE

	135.23	137.28	
Emërtimi	2016	2015	Δ %
Fluksi i parave nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit	1,187	729	63
Rregullime për:			
Amortizimin	161	98	65
Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktiviteti, si dhe kërkesave të arkëtueshme të tjera	(2,054)	(6,275)	(67)
Rritje/rënie në tepricën inventarit	(83)	(108)	(23)
Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti	721	7,715	(91)
Paratë e përftuara nga aktiviteti shfrytëzimit	(67)	2,159	(103)
Interesi i paguar	-	(29)	(100)
Tatimfitimi i paguar	(188)	(131)	43
Paraja neto, e përdorur në aktivitetet shfrytëzim	(256)	1,999	(113)
Fluksi i parave nga veprimtaritë investuese			
Bleria e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(345)	(115)	199
Paraja neto, e përdorur në aktivitetet investuese	(345)	(115)	199
Fluksi i parave nga veprimtaritë Financuese			
Fluksi i parave nga veprimtaritë financiare	(397)	(1,000)	(60)
Dividendet e paguar	(30)	-	
Paraja neto e përdorur në aktivitetet financiare	(426)	(1,000)	(57)
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare	(1,027)	884	(216)
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	1,945	1,032	88
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	918	1,916	(52)

PASQYRA E LËVIZJES SË KAPITALEVE

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore statutore	Fitimi i pashperndare	Totali
Pozicioni me 31dhjetor 2014	1,390	9	785	2,184
Fitimi neto per periudhen kontabel	-	-	-	-
Rivleresim Asetesh	-	-	729	729
Rritje e kapitalit	785	-	(785)	-
Dividendet e paguar	-	-	-	-
Pozicioni me 31 dhjetor 2015	2,175	9	729	2,914
Fitimi neto per periudhen kontabel	-	-	-	-
Dividendet e paguar	-	-	1,009	1,009
Rritje e rezerves se kapitalit	-	-	(30)	(30)
Rritje e kapitalit	700	-	-	700
Pozicioni me 31 Dhjetor 2016	2,919	9	(711)	(711)
	-	-	-	-
Pozicioni me 31 Dhjetor 2016	2,919	9	1,009	3,937

